

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

E lidhur në Tiranë, sot më 26 / 10 / 2022 ndermjet paleve si me poshte vijon:

**Z. Gezim Prenga** shtetas shqiptar, lindur me 04.05.1975, lindur ne Rreshen, dhe banues ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Karte Identiteti Nr. Personal H50504030W, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si Dhurusi,

**Z.Marsel Daka** , shtetas shqiptar, lindur me 06.11.1998 ne Peqin , dhe banues ne Peqin, mbajtes i dokumentit te identifikimit, Karte Identiteti, me Nr. personal J81106017A, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte i njohur si I dhuruari ,ose Perfituesi

### MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë “EUES Energy” Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L39406001N, me seli ne adresen: , Rruga At Gjergj Fishta Rreshen, (me poshte referuar “*Shoqeria*”);
- B. Shitesi deshiron t'i dhuroje 28% te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Shoqerine e siperpermendur.
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakut te vetem te shoqerise, per shitjen e kuotave te shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

**PER SA ME SIPER**, palët bien dakord si vijon:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Dhuruesi i dhuron 28% te kuotave te kapitalit te Shoqerise "EUES Energy" Sh.p.k Perfituesit
2. Transferimi i pronësisë mbi kuotat dhe regjistrimi i transferimit behet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pavarësisht mënyrës se pagimit te çmimit te shitjes te përcaktuar këtu.
3. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit te transferuara ketu, janë ne pronesine e tij te plote e ligjore dhe te lira nga barra hipoteke apo pengje.
4. Perfituesi pranon pronësinë e kuotave, 28% te kapitalit te Shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqerise dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Perfituesi behet zotërues i 28% te kuotave te kapitalit te Shoqerise.
5. Perfituesi mer persiper pagesen e detyrimeve tatimore qe lindin nga realizimi i ketij transakcioni lidhur me Tatimin ne Burim, per fitimin e realizuar nga shitja e kuotave.
6. Dhuruesi dhe Perfituesi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit te kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale ne gjuhen Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, Date 14.04.2008. Marrëveshja pasi u lexua prej palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

#### PALET

**Dhuruesi**

**Gezim Prenga**



**Perfituesi nga dhurimi**

**Marsel Daka**

